Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 05/17
Datë/Datum. 24.01.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **Ministria e Shëndetësisë**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr.05/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Sigurimi fizik i MSH-së dhe depos së barnave për Lot 1 dhe Lot 2"**, me nr. prokurimi: **206/16/062/221**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE "Security Code" sh.p.k- PRISHTINË**		
Datë:	**24.01.2017**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Sigurimi fizik i MSH-së dhe depos së barnave për Lot 1 dhe Lot 2"**, me nr. prokurimi: **206/16/062/211"**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: OE "**Security Code**", me seli në – Prishtinë, me nr.prot.05/17, i datës 06.01.2017

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

Raporti i ekspertit shqyrtues për lëndën: **"Sigurimi fizik i MSH-së dhe depos së barnave për Lot 1 dhe Lot 2"**, me nr. prokurimi: **206/16/062/221"**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Shëndetësisë.**

RAPORTI MBI EKSPERTIZËN E EKSPERTIT SHQYRTUES:

		16.01.2017		18.01.2017		24.01.2017
Nënshkrimi i ekspertit		Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit të ekspertizës

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit.

Me datë: 06.01.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me numër të protokollit 05/17 e parashtruar nga operatori ekonomik "Security Code"-sh.p.k lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sigurimi fizik i MSH-së dhe depos së barnave për Lot 1 dhe Lot 2", me nr. prokurimi: 206/16/062/221", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-Operatori Ekonomik Ankues: "Security Code"-sh.p.k- Prishtinë.

Kërkesa jonë për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin mbi dhënien e kontratës

Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 7, par. 1, nën-paragrafin (vi) të paragrafit 6 të LPP-së

Rregullorja për Prokurimin Publik Neni 17, par. 1

Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 35.3 pika 1,3,4,5,6 dhe 7 të UOPP-së

Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 52, par. 3 të LPP-së

Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 59, par.4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/1-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 60, par. 1 të LPP-së

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 35.3 të UOPP-së, 35.3 Parimet kryesore të procedurës së vlerësimit sipas LPP janë:

1. Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kërkesat formale administrative të specifikuara. 3. Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuara. 4. Tenderët e përgjegjshëm do të vlerësohen në bazë të kritereve të specifikuara të dhënies së kontratës. 5. Vetëm

kërkesat dhe kritere e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdorën si bazë për vlerësim. 6. Asnjë komunikim , diskutim ose negocim nuk duhet të ndodhë në mesë të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve gjatë procedures së vlerësimit. 7. Megjithatë, vetëm sqarim i tenderëve mund të ndodhë pa ndonjë ndryshim të kushteve material ose aspekte të tenderit.

-Ku sipas këtyre pikave: Vetëm kërkesat dhe kritere e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftimin për kontratë/dosje të tenderit mund të përdoren si bazë për vlerësim. -Në dosjen e tenderit tek Ankesi 1, Specifikimet teknike të detyrueshme të lëshuar nga MSH të gjithë OE ju keni cekur kriteret si më poshtë: Para dhënies së kontratës nga OE fitues kërkohet të ofrohet Deklarata me shkrim se:

- Se do t'iu paguani të gjithë punëtorët pagë jo me pak se 250 € neto, konform ligjit të punës në fuqi dhe të kenë kontrate me kompaninë dhe pagesën e të gjitha kontributeve ne Administratën tatimore te parapara me ligje te Republikës se Kosovës.

- Rrogat e punëtoreve duhet te derdhen ne llogarit e tyre jo me larg se me datën 5 në

fillim të çdo muajit.

- Në pyetjet dhe përgjigjet për sqarim shtesë kemi pranuar informacione rreth kalkulimit të ofertës tonë ju keni cekur si më poshtë: Pyetje: Në ANEKS 1: Specifikimet teknike të detyrueshme: paragrafi i fundit theksohet se kushte për OE fitues është niveli i pagës 250€ neto. A është ky kusht për vlerësimin e ofertës financiare, nëse po, çka duhet të përfshihet mbi pagën NETO, për të ardhur deri tek kalkulimi final? Përgjigje: Për kërkesën e specifikuar në Ankes 1 rreth pages Neto prej 250 euro, kjo është kërkesë mjaft e qartë dhe ju duhet ta keni parasysh në ofertën tuaj.

- Me vetë faktin që ju i keni cekur këto kritere, ju keni bërë shkelje, pasi që OE që është shpërblyer me kontratë nuk e plotëson këtë kriter.

*Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 52 par.3 të LPP-së

Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund

të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kritere të tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pas-shitjes dhe asistenca teknike.

*Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 59 par.4 të LPP-së, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. - Me çrast ju keni bërë shkelje pasi që OE i shpërblyer me kontratë ashtu siq e kemi cekur më lartë nuk duhet të jetë i përgjegjshëm pasi që kriterin e kërkuar për paga dhe Ligjin e Punës Nr. 03/L-212 nuk i ka plotësuar.

*Supozohet se Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 60 të LPP-së par.1, Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose:

1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

- Këtë e themi pasi që OE i shpërblyer me kontratë nuk është i përgjegjshëm për mendimin tone dhe për këtë ne shprehim besimin tonë në drejtësin e Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe kërkojmë nga ky organ që të zhvillojë seancë në të cilën do ti konstatoj shkeljet e AK dhe pas kësaj të nxjerrë vendim meritor-ta detyroj AK - MSH që ti rrespektoj kriteret e DT para se të merr vendime të tilla jo meritore për këtë aktivitet të prokurimit, për arsye të ndryshme jo të parapara në Ligjin Nr.04/L-042 për PPRK, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092, dhe të RIVLERËSOJ këtë aktivitet të prokurimit, pasi që në mënyrë të qartë janë shkelur kriteret dhe nën kriteret e përcaktuara në DT.

- Provë:

1. Analiza Financiare - Security Code shpk
2. Analiza Financiare - Besa Security
3. Analiza Financiare - Alpha Private Security (OE Fitues i shpallur).

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit në KRPP-së për kontratë (N.35) :.....24.10.2016
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-.....Procedur e hapur
Lloji i kontratës së publikuar(N.16): .....kontrat shërbim
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 22.11.2016
Data e hapjes së ofertave (N.58):.....22.11.2016-ora 14;30h
Njoftimi për dhënien e kontratës.....21.12.2016
Kriter për dhënien e kontratës.....Çmimi më i lartë

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Tenderuesi	Vendi	Lot-	Çmimi	Vëretje
1	"Security Code"	PRISHTINË	Lot-I Lot-II	69,840.00€ 55,872.00€	JO
2	"Alpha private Security"	PRISHTINË	Lot-I Lot-II	60,425.00€ 48,340.00€	JO
3	"Rojet e Nderit"	PRISHTINË	Lot-I Lot-II	63,397.80€ 50,718.24€	JO
4	"Rosa Security"	PRIZREN	Lot-I Lot-II	53,100.00€ 42,480.00€	1 kopje
5	"SFK Security"	PRIZREN	Lot-I Lot-II	52,020.00€ 41,616.00€	1 kopje
6	"Commando skifterat"	PRIZREN	Lot-I Lot-II	60,425.67€ 48,340.548	
7	"Luani" shpk	PRISHTINË	Lot-I Lot-II	56,208.96€ 44,965.80€	Vones në hapje
8	"Ks Besa Security"	PRISHTINË	Lot-I Lot-II	63,743.40€ 50,994.72€	Vones në hapje
9	"Ks As Security"	PRISHTINË	Lot-I Lot-II	60,427.80€ 48,342.24€	
10	"Delta Security"	PRISHTINË	Lot-I Lot-II	60,679.27€ 48,376.22€	20 min vones

Në këtë aktivitet të prokurimit, ka marrë pjesë (10) operator ekonomik, në procesverbal të hapjes janë rexhistruar vërejtje në lidhje me hapjen e ofertave, lidhje me OE Rosa Security, SFK Security, Luani sh.p.k dhe Besa Security.

Kriteret për kualifikim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.
2. 2. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit.
3. 3. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës se publikimit te njoftimit te kontrates.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklarata nën Betim
2. Vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente – vetëm për fituesin para dhënies se kontratës.
3. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore – vetëm për fituesin para dhënies se kontratës.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet te dëshmoj regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve ne vendin e juaj te themelimit. Kërkohet një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend. 2. Operatori ekonomik duhet te dëshmoj regjistrimin ne regjistrin Fiskal. 3. Operatori ekonomik duhet te dëshmoj regjistrimin për TVSH për secilin partner te një grupi operatoresh ekonomik – kjo vlen vetëm për kompanitë e regjistruara ne Kosove. 4. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë e lëshuar nga MPB dhe autorizimi për nisjen fillestare të veprimtarisë të lëshuara nga MPB, sipas Ligjit për Shërbimet Private te Sigurisë nr. 04/L-004.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Kopje e certifikatës së biznesit 2. Kopje e Certifikatës se Numrit Fiskal 3. Kopje e Certifikatës se TVSH-se (për kompanitë vendore) 4. Licenca për ushtrimin e veprimtarisë e lëshuar nga MPB

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Operatori ekonomik duhet te deshmoj se paku nje kontrate te ngjashme te realizuar ne tri vitet e fundit (2013, 2014, 2015)

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Minimumi nje reference per kryerjen e sherbimeve te ngjashme ne tri vitet e fundit (2013, 2014, 2015)

Komisioni vlerësimit pran AK-së:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.80).

Petrit BRUQI: Kryesues,
Ndriqim VESELAJ: Anëtar,
Alban POZHEGU; Anëtar,

Komisioni vlerësues ka përfunduar punën (raportin e vlerësimit), me datë 19.12.2016.

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni i vlerësimit ka vlerësuar me kujdes te dhjete ofertat e pranuara dhe ne baze te dokumentacionit te ofruar, REKOMANDON se oferta Alpha Private Security eshte e përgjegjshme me çmim me te ulet te ofruar per te dy lotet, ne vlere prej 108,765.00€.

Përgjigjje në pretendimet ankimore nga Ekspertit shqyrtues: (N. 113.1), konform njoftimit të OSHP-së të datës 19.11.2014, nr.prot.848/14:

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të lëndës së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kanë pasur në dispozicion eksperti shqyrtues jep mendimin si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron:
Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontrat për shërbim, vlerë e mesme, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi i përgjegjshëm çmimi më i ulët".

I pakënaqur me njoftimin për dhënien e kontratës të datës 21.12.2016, për këtë aktivitet të prokurimit, OE ankues: "Security Code"sh.p.k, fillimisht ka parashtruar ankesë në Autoritet kontraktues, dhe pastaj duke parashtruar ankesë edhe në OSHP me datë 06.01.2017, me pretendim ankimor se nuk është respektuar:

Neni 7, parag. 6 i LPP-së (Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi),

Neni 52.3 i LPP-së (Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës),

Neni 59.4 të LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve),

Neni 60.1 të LPP-së (Kriteret për Dhënien e Kontratës),

Neni 17.1 i Rregullores per Prokurim,

Nenin 35.3, paragrafi 1,3,4,5,6 dhe 7 i UOPP.

Ne interpretim të asaj që u tha më lartë, po sqarojmë se i kemi shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndes, konkretisht ato që lidhen me zbatim të vendimit të lartë përmendur (pretendimeve ankimore) dhe atë si në

vijim:

Pretendimi ankimor nr.1

Eksperti shqyrtues fillimisht s'qaron se kemi një pretendim ankimor në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit i parashtruar nga OE ankues, i cili ka të bëjë me kriterin e kërkuar në dosjen e tenderi sa i përket pages neto 250€, për të punësuarit në lidhje me këtë projekt,

Në lidhje me këtë, Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor i parashtruar nga OE ankues sa i përket pages neto prej 250€ për të punësuarit në këtë aktivitet të prokurimit të kërkuar në FDT-së tek specifikimi teknik të detyrueshem Aneks 1, paragrafi i fundit është kërkuar:

- ***para dhënies së kontrates nga OE fitues kërkohet të ofrohet Deklarata me shkrim se: do t'iu paguani te gjithe punetoret pag jo me pak se 250€ neto, konform ligjit te punes ne fuqi dhe te kenë kontrate me kompanine dhe pagesen e te gjitha kontributeve ne Administraten tetimore te parapar me ligje te Republikes se Kosoves.***
- ***Rrogat e punetoreve duhet te derdhen ne llogarit e tyre jo me larg se me daten 5 ne fillim te çdo muaji.***

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në këtë kriter të FDT-së vlerëson se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar deklarat me shkrim sipas kërkesës së FDT-së ku deklaron se paga e punëtoreve do të jetë neto 250 €, si dhe i njëjti ka ofruar çmimin e ofertës në harmoni me këtë kriter të FDT-së, ku dëshmohet se çmimi i ofruar mbulon pagat për punëtoret që do të angazhohen në këtë projekt, sipas kërkesës së FDT-së.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se përgjegjegjës për implementimin dhe mbikëqyrjen e kontratës është Autoriteti kontraktues i cili është i obliguar që të implementoj këtë kontrat në harmoni me kriterin e lartë cekur të FDT-së sa i përket pagave të punëtoreve, duke u bazuar në atë se implementimi i kontratës është fazë e mëvonshme e cila mbikëqyret nga ana e AK-së.

Eksperti shqyrtues vlerëson se komisioni vlerësues nga ana e autoritetit kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit të ofertave ka vepruar në harmoni me nenin 52 dhe 59 të LPP-së, duke vlerësuar ofertat në harmoni me kërkesat e FDT, poashtu në harmoni me nenin 7 të LPP-së ka trajtuar OE ankues duke mos diskriminuar, ndërsa rekomandimi për shpërblim me kontratë është bërë në harmoni me kriterin për shpërblim me kontrat ku është rekomanduar OE i përgjegjshëm me çmim më të ulët, në harmoni me nenin 6 dhe 60.1.1.1 të LPP-së.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të REFUZOJ si të pa-bazuar, ankesën e OE ankues "Security Code"sh.p.k, me seli në Prishtinë, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të APROVOJ vendimin e Autoritetit kontraktues, Njoftimi për dhënien e kontratës i datës 21.12.2016, për këtë aktivitet të prokurimit: "Sigurimi fizik i MSH-së dhe depos së barnave për Lot – 1 dhe Lot - 2", me nr. prokurimi:616/16/107/211 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.